

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“Blerje materiale ndërtimi viti 2024 për rehabilitimin e rrugëve dhe objekteve në zona të ndryshme të Bashkisë”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

441100000-1 Materiale ndertimi

**VLERA E FONDIT LIMIT: 16.666.666,67 (Gjashtëmëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje gjashtëdhjet e shtate) lekë pa tvsh**

I mbajtur sot me date \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024 ne Autoritetin Kontraktor Bashkia Finiq, ne mbledhjen e njesise se prokurimit te perbere prej Florida Lula, Eduart Merkuri, Foto Thanasi ngritur sipas Urdhërit te Prokurimit Nr.3, datë 19.02.2024 per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve te veçanta te pranimit te procedures se prokurimit me objekt: **“Blerje materiale ndërtimi viti 2024 për rehabilitimin e rrugëve dhe objekteve në zona të ndryshme të Bashkisë”**, prokurim elektronik “Procedure e hapur ,Mallra”, me fond limit **16.666.666,67 (Gjashtëmëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje gjashtëdhjet e shtate) lekë pa tvsh**, sipas perllogaritjeve te kryera, referuar vleres se preventivit hartuar nga Drejtoria e shërbimeve Publike.

Është zgjedhur kjo procedurë në mbështetje të Nenit 42 të LPP-së.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Finiq ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 8;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 3

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

#### **2.1.1** Sipas kritereve te pergjithshme te pranimit/kualifikimit

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare (2020.2021.2022) , ku vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë në një vlerë jo më të vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (b) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020,2021,2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c", të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të

kontabilistit të miratuar” , ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

**2.2.3.** Vertetim të leshuar nga autoritetet vendore, për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara për vitin 2023, sipas shtojcës nr.8 (Formulari përmbledhës i vetedeklarimit)

Për plotësimin e kriterit të mesipër të pikës është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 (Formulari përmbledhës i vetedeklarimit).

*Ne lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit deshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, mbajme në konsideratë përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar , ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2 të këtij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqeruese të ofertes, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Vlera totale e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi,

dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 40 pika 4 e VKM-se nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është përcaktuar që *”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit ku vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”*. Në rastin konkret vlera e kërkuar nga AK është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

---

**2.3.2** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e furnizimit të mallrave objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 5 (pese) persona**.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

*Ne zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues si më poshtë:*

- Listpagesat sipas formularit satandart për sigurimet
- Vertetim nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguruar.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Nisur nga mallrat objekt kontrate të cilat janë parashikuar në preventiv që do të dorëzohen në destinacione të ndryshme, sipas përcaktimeve të kryera nga AK, nevojiten 3 (tre) punonjës duhet

te jene si drejtues te automjeteve betoniere, 1 (nje) punonjes drejtues automjeti kamion vetshkarkues dhe 1 (nje) punonjes si punetor per ngarkim shkarimin e mallit.

**2.3.3** Operatorët Ekonomik duhet të kenë të punësuar 3 (tre) drejtues automjetesh per autobetoniere dhe 1 (nje) drejtues mjete per kamion vetshkarues.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punojësve te siperpermendur.

*Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne renditje pas mbylljes se fazes se vleresimit duhet te dorezoje prane AK,perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, te gjithë dokumentacionin provues si me poshte:*

- kontratë pune të vlefshme
- dëshminë e drejtimit të automjetit e vlefshme
- si dhe të figurojnë në list-pagesat e sigurimeve shoqerore.

Në rastin kur makineritë disponohen me qera, për drejtuesit e mjeteve nuk do te kërkohen list-pagesat e Sigurimeve Shoqerore.

**Argumentimi:** Në zbatim të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Urdhërin Nr. 109, datë 05.08.2013 ”Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, pasi per dorezimin e mallrave sipas zerave te preventivit ne pikat e percaktuara nga AK ,kërkohen specialistet e siperpermendur.

**2.3.4** Operatori ekonomik te duhet te kete impjant **prodhimi betoni** pronesi/përdorim me qera ose kontrate furnizimi për mallin objekt prokurimi.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e impiantit te prodhimit te betonit pronesi/përdorim me qera ose kontrate furnizimi.

*Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne renditje pas mbylljes se fazes se vleresimit duhet te dorezoje prane AK,perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, te gjithë dokumentacionin provues si me poshte:*

*Ne rastin e impiantit ne pronesi:*

- Dokumentat e pronesise se impiantit

- *Leje mjedisore kodi III.1.b.*

*Ne rastin e impiantit me qera:*

- *Kontraten e qerese lidhur para noterit , shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë të impiantit të prodhimit të betonit ,si dhe Lejen mjedisore kodi III.1.b, me afat deri në përfundim të kontratës.*

*Ne rastin e kontrattes se furnizimit:*

- *Kontrate furnizimi lidhur para noterit, shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë te impiantit të prodhimit të betonit , me afat deri në përfundim të kontratës, si dhe të ketë të përcaktuar sasinë e betonit te kerkuar nga AK.*

**Argumentimi:** Në zbatim të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion me qera ose kontrate furnizimi impiant per prodhim betoni i domosdoshem për të përmbushur kontratën.

Eshte kërkuar ky impiant në përputhje me volumet e zërave të preventivit, llojit të mallit, konkretisht beton i gatshem C 20/25, me nje volum te pergjithshem prej 1910 m<sup>3</sup> , percaktuar sipas manualit të MPPT miratuar me VKM nr.216, datë 13.04.2023.

**2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

NR.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Autobetoniere	3 copë	Në pronësi ose me qera
2	Kamion vetshkarkues me vinç me kapacitet mbi 15 T	1 copë	Në pronësi ose me qera

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e makinerive te siperpermendura.

*Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne renditje pas mbylljes se fazes se vleresimit duhet te dorezoje prane AK,perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, te gjithe dokumentacionin provues si me poshte:*

*a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:*

- 1. Leje qarkullimi (e vlefshme)*
- 2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*

3. *Police sigurimi (e vlefshme)*
4. *Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme*

b) *per mjetet me qera,*

1. *Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj, I cili duhet te jete deri ne perfundim te kontrates.*
2. *Leje qarkullimi (e vlefshme)*
3. *Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*
4. *Police sigurimi (e vlefshme)*
2. *Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme.]*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Janë kërkuar këto makineri në përputhje me volumet e zërave të preventivit.

Malli beton C 20/25 ne nje volum te pergjithshem prej 1910 m<sup>3</sup> objekt prokurimi do te transportohen e me tej dorezohen ne pikat e percaktuara nga AK me Autobetoniere. Jane kerkuar tre Autobetoniera pasi nga AK eshte parashikuar qe ne dite te caktuara do te merret nje sasi e konsiderueshme betoni per tu perdorur per rikonstruksion rrugesh te fshatrave te bashkise me vendodhje te largeta, çka kushtezon qe furnizimi te kryhet nga tre Autobetoniere per te realizuar me efikasitet punen e parashikuar.

Mallrat e tjera te perfshira ne preventiv do te transportohen me kamion veshkarkues gjithashtu ne pikat e percaktuara nga AK. Kamioni duhet te jete me vinç pasi do te kryeje njekohesisht dhe ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave objekt prokurimi.

**2.3.6** Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

- Certifikat e sistemit te menaxhimit te cilesise ISO 9001:2015;

**Argumentimi:** Eshte vendosur ky kriter në përputhje me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 77, pika 4 , VKM nr.285, dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“, neni 44, si dhe natyrës së mallrave qe do te furnizihet AK .

Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikat te sistemit te menaxhimit te cilesise ISO 9001:2015, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë së shërbimit që ofron.

## **2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

### **2.4.1** Operatori ekonomik duhet te paraqese:

Grafiku i levrimit te maallrave sipas të gjitha zërave të preventivit.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Sa me siper Njesia e Prokurimit

### **vendosi:**

1. Miratimin e specifikimeve teknike te objektit **“Blerje materiale ndërtimi viti 2024 për rehabilitimin e rrugëve dhe objekteve në zona të ndryshme të Bashkisë”**, hartaua nga Sektori i Mirembajtjes se Rrugeve Rurale prane Drejtorise se sherbimeve Publike,Bashkia Finiq.
2. Miratimin e krietereve te veçanta te procedures se prokurimit me objekt **“Blerje materiale ndërtimi viti 2024 për rehabilitimin e rrugëve dhe objekteve në zona të ndryshme të**



**Bashkisë"**

3. Ne zbatim të VKM-së nr. 285 date 19.05.2021, neni 45, pika 2, Kriter vleresues te jete:  
**- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim**

4. Procedura per hapjen e ofertave do te zhvillohet ne daten 02.04.2024, Ora 09<sup>00</sup>

Ne zbatim te manualit te miratuar me Udhezimin nr.7, date 30.07.2021 "Per menyren e zhvillimit te procedures se prokurimit me mjete elektronike", të Agjencisë së Prokurimit Publik, Njesia e Prokurimit autorizon znj.Florida Lula per te kryer veprimet ne Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

**PER NJESINE E PROKURIMIT**

Florida LULA

Eduart MERKURI

Foto THANASI